



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



# Konventa Kombëtare për Integrimin European

## Ligji për vullnetarizmin në Shqipëri – si prioritet për zhvillimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile

E martë, 9 korrik 2024, 10:00 – 12:00

### REKOMANDIME

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka filluar punën për hartimin e projekt-ligjit për Vullnetarizmin që i dedikohet aktorëve të shoqërisë civile, aktivistëve, të rinjve dhe rrjeteve të vullnetarëve në vend.

Me anë të këtij projekt-akti synohet që të adresohen dhe zgjidhen ato çështje që rezultuan shqetësuese gjatë zbatimit të Ligjit për Vullnetarizmin 45/2016, problematika që u ngritën nga organizata të shoqërisë civile, të cilat ofruan dhe rekomandime e sugjerime sesi ligji duhet të përmirësohet që të bëhet i zbatueshëm dhe të shmangen pengesat dhe barrierat që sjell ai për OSHC-të.

Rishikimi i Ligjit për Vullnetarizmin është një nga prioritetet e vendosura në Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike (një nga piketat hapëse për Grupimin 1 të kapitujve të BE-së – Themelore) në kuadër të integritimit european të vendit dhe ky rishikim duhet të miratohet brenda vitit 2025, me qëllim për të forcuar mjedisin mundësues për shoqërinë civile në vend për më shumë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, bashkëpunim efektiv dhe kontribut të qenësishëm të shoqërisë civile në proces. Ky draft-ligj sjell amendime për ligjin ekzistues 45/2016 dhe pritet që drafti i parë të jetë gati për konsultim publik në shtator 2024.

### Qartëzimi i përkufizimeve dhe kuadri ligjor

- Kërkohet një qartëzim i përkufizimit çfarë do të quhet vullnetarizëm dhe çfarë nuk është vullnetarizëm. Rekomandohet që të shmangët termi *punë vullnetare* dhe vullnetarizmi të përkufizohet si *akt, veprim, por jo punë* pasi nuk është marrëdhënie pune. Këtu duhet bërë dhe një dallim i qartë ndërmjet shërbimeve sociale apo praktikave profesionale të punës, që

\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE  
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



nuk duhet të konsiderohen si vullnetarizëm. Nga ana tjetër duhet bërë dallimi mes vullnetarizmit të strukturuar dhe vullnetarizmit masiv, dhe në këtë rast duhet të mundësohet që vullnetarizmi masiv të jetë pa barriera formale dhe detyrime financiare për Vullnetarët dhe organizatat Ofruese të Vullnetarizmit.

- Element tjetër me rëndësi që ligji duhet të qartësojë është dhe **njohja e kompetencave apo njohja e eksperiencës vullnetare** si eksperiencë profesionale. Rekomandohet që në rastin e vullnetarizmit masiv nuk ka nevojë për një njohje të tillë, por në raste të vullnetarizmit të strukturuar mund të jetë e nevojshme që përveç njohjes që bëhet nga organizata ofruese apo nga programet përkatëse, të ketë dhe një autoritet përkatës që të bëjë të mundur certifikimin e eksperiencës bazuar në vlerësimin e kompetencave të fituara gjatë angazhimit vullnetar (kompetencat e të nxëniet dhe/ose aftësive profesionale).
- Një tjetër qartëzim për përkufizimet lidhet me palët dhe aktorët që do të përfshihen në marrëdhënien e kontributit vullnetar, pra më specifikisht çfarë duhet të konsiderohet **organizatë ofruese e vullnetarizmit**, cili konsiderohet **vullnetar** dhe cili konsiderohet **përfituesi i aktit vullnetar** (që mund të jetë subjekt fizik ose juridik, dhe mund të jetë i ndryshëm nga organizata ofruese e vullnetarizmit). Ky qartësim bën të mundur që të dalin qartë dhe saktë në marrëveshjen për vullnetarizmin detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë.
- Koncepti i **vullnetarit** nuk duhet të kufizohet vetëm te të rinjtë por duhet të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë të gjitha moshat, dhe duke targetuar të gjitha grupet dhe komunitetet shoqërore (duke përfshirë dhe të huajt). Rekomandohet gjithashtu që mund të ketë një rishikim të moshës së vullnetarizmit ku mund të ketë *një ulje* për të përfshirë dhe adoleshentët apo fëmijët të cilët angazhohen në nisma vullnetare.
- Një vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet dhe fushave dhe sektorëve që mund të ndikojnë në promovimin e aktiviteteve vullnetare dhe përfshirjen e target grupeve të ndryshme. Rekomandohet që në këtë drejtim më shumë vëmendje duhet të orientohet dhe ndaj *sportit*, aktiviteteve sportive dhe rekreative të cilat mund të ofrojnë hapësira dhe mundësi për më shumë angazhim vullnetar dhe për rritjen e vullnetarizmit apo dhe kontributit dhe angazhimit që ofrojnë dhe *komunitetet fetare* në Shqipëri.

\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit  
“Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet  
Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin  
e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil  
Society Facility 2021





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



- Rregullimi i vullnetarizmit me ligj të shmangë rregullimin e vullnetarëve në kuptimin që ata duhet të jenë të regjistruar në mënyrë që të ofrojnë vullnetarizëm pasi kjo sjell **burokraci** dhe kërkon nga organizata ofruese e vullnetarizmit kapacitete dhe burime shtesë për tu marrë me këtë proces. Gjithashtu në rastin e vullnetarizmit masiv bëhet pothuaj e pamundur që të realizohet një regjistrim i tillë për secilin vullnetar.
- Rregullimi i ligjit për vullnetarizmin duhet të bëhet në një optikë më të gjerë duke marrë në **konsideratë kuadrin ligjor kombëtar dhe ligjet e tjera** dhe çështjet horizontale që ndikohen nga apo ndikojnë vullnetarizmin, si ligji për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ligji për punësimin, ligji për shërbimet sociale, ligji për rininë, ligji për arsimin etj.
- Duhet më shumë **mbështetje dhe përfshirje nga ana e institucioneve shtetërore** për vullnetarizmin. Ofrimi i shërbimit të vullnetarizmit nuk është pa kosto për organizatat që e ofrojnë, për këtë rekomandohet:
  - Një **fond dedikuar** vullnetarizmit dhe organizatave që ofrojnë vullnetarizëm. Kjo mund të realizohet si në rastin e Sllovakisë, ku një organ akreditues akrediton organizatat ofruese të vullnetarizmit ( në rast se plotësojnë kriteret e vendosura, të cilat nuk duhet të jenë shumë të ngurta dhe kërkuese) dhe pas marrjes së akreditimit këto organizata bëhen automatikisht përfituese të fondit të dedikuar.
  - Shteti mund të mbulojë **pagesën e sigurimeve** të shëndetit apo të lëndimeve në punë për vullnetarët, duke i lehtësuar kështu organizatat ofruese. Kjo do të ulte kostot ekonomike për organizatat dhe do të rriste angazhimin dhe incentivën e tyre për më shumë vullnetarizëm.

## Detyrimet dhe të drejtat nga marrëdhënia kontraktore për vullnetarizmin

- Të **qartësohet natyra e marrëdhënies ligjore** dhe kontraktore midis Vullnetarit dhe Ofruesit të Vullnetarizmit, kjo me qëllimin për të qartësuar, mbi të gjitha, detyrimet përkatëse tatimore, për kontributet, etj., dhe shmangiet ligjore nga këto detyrime.

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit  
"Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet  
Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin  
e anëtarësimit në BE", me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil  
Society Facility 2021*





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Marrëdhënia e vullnetarizmit **nuk mund të jetë** as marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie shërbimi.

- Rekomandohet që marrëveshjet mes vullnetarit, organizatës ofruese vullnetare dhe/ose përfituesit të vullnetarizmit të jenë sa më fleksibël, me sa më pak burokraci dhe shtrëngime, dhe ku të dalin qartë detyrat dhe të drejtat e secilës palë.
- Dispozita e **Nenit 16(2)** duhet të hiqet nga Ligji 45/2016. Kushtet e pavlefshmërisë së kontratave konstatohen dhe deklarohen sipas kushteve dhe parashikimeve në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Duhet të qartësohet edhe **natyra dhe lloji i sigurimit** për Vullnetarët sipas **Nenit 22** për t'i hapur rrugën zbatimit të drejtë të ligjit nga të gjithë subjektet e interesuara (në mënyrë që qartësimi të mos mbetet vetëm i shpjeguar me një vendim teknik të DPT - shih rekomandimin 1 më sipër). Sigurimi i vullnetarit në skemën e sigurimeve shoqërore nga aksidentet në punë dhe për pension pleqërie duket me vend në marrëdhënien e vullnetarizmit; ky sigurim mund të bëhet nga shteti. *Problematika e hasur nga ligji ekzistues është në rastin kur personat që janë njëkohësisht përfitues të ndihmës sociale, angazhohen si vullnetarë dhe pasi paguhen nga organizata ofruese sigurimi shoqëror, përbën problem për të përfituar ndihmën shoqërore, pasi në një rast të tillë, për shkak të paqartësisë së procesit dhe mosidentifikimit nga sistemi ai figuron si një i punësuar. Pra situata është që personat që janë përfitues të ndihmës sociale në raste kur angazhohen si vullnetar me ligjin ekzistues rrezikojnë të humbasin asistencën.*
- Rekomandohet që të realizohet dhe të merren në konsideratë gjatë vendosjes së marrëdhënies kontraktuale vullnetar-organizatë ofruese dhe/ose përfitues krijimi i një dokumenti udhëzues dhe informues **për të siguruar mbrojtjen nga abuzimi** dhe rreziqet e tjera që mund të vijnë gjatë shërbimit vullnetar si shfrytëzimi për punë, dhuna verbale apo fizike, apo dhe rreziku i ngacmimit dhe abuzimit seksual. Sidomos ku në këtë marrëveshje përfshihen dhe kategori të veçanta si të mitur, persona me probleme të shëndetit mendor apo fizik, grupe të marginalizuara etj.

\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit  
"Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet  
Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin  
e anëtarësimit në BE", me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil  
Society Facility 2021





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



- Në këtë drejtim duhet punuar më shumë në **ndërgjegjësimin dhe informimin** e personave të përfshirë në shërbimin vullnetar (qofshin vullnetarë apo përfitues) mbi mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe se si të procedojnë në rast të problematikave për të raportuar apo për tu ankuar në instancat e duhura shtetërore.

## Identifikimi, regjistrimi dhe të dhënat për vullnetarizmin

- **Mungojnë studimet** mbi vullnetarizmin dhe **të dhëna të sakta** mbi numrin e organizatave që ofrojnë vullnetarizëm në vend, numrin dhe llojin e vullnetarëve dhe të dhëna të tjera të nevojshme për kontributin vullnetar (lloji, kohëzgjatja, target grupet, tipologjia e vullnetarit dhe e përfituesve, fushat kryesore të kontributit vullnetar etj.). Këto studime konsiderohen të rëndësishme për të kuptuar gjendjen reale të vullnetarizmit në vend dhe për të orientuar politikat për vullnetarizmin. Studimet rekomandohet të realizohen nga institucionet publike, në bashkëpunim dhe me organizatat e shoqërisë civile që mund të japin kontribut në këtë drejtim me eksperiencën dhe kapacitetet e tyre.
- Rregullimi me ligj i vullnetarizmit dhe, veçanërisht, përdorimi i **Regjistrimit të Vullnetarëve** të bëhet në funksion të vlerësimit të kontributit të vullnetarëve në shoqëri dhe të shmangen potencialet për keqpërdorim të informacionit të Regjistrimit për ngarkesa financiare, fiskale, etj., për Vullnetarët dhe organizatat Ofruese të Vullnetarizmit. Ligji të përcaktojë qartë dhe në mënyrë shtruese qëllimin dhe funksionin e Regjistrimit. Pra në radhë të parë nëse një regjistër i tillë do të ngrihet, rekomandohet që të bëhet një analizë e detajuar dhe e plotë mbi qëllimin, dobinë dhe përfitimet që ky regjistër do të sillte për procesin në lidhje me vullnetarizmin
- Regjistrimi i vullnetarëve në një regjistër online, **sjell kosto shtesë** për organizatat në kohë, në burime njerëzore dhe financiare. Sidomos kjo bëhet shumë e vështirë në rastin e fushatave të vullnetarizmit masiv. Kjo ngarkesë administrative mund të jetë e papërbalueshme për një numër të lartë organizatash, duke ulur incentivën e tyre për të ofruar vullnetarizmin për shkak të pengesave burokratike

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility 2021*





Financuar nga  
Bashkimi Evropian



- Rekomandohet që të merret në konsideratë që për ngritjen e një regjistri të tillë duhet dhe një **mekanizëm i mirë i mbrojtjes dhe moskeqpërdorimit të të dhënave personale** që do të mbajë ky regjistër. Pasur parasysh rrezikun e lartë të krimeve kibernetike si dhe rastet e mëparshme ku të dhënat personale të qytetarëve nuk janë mbrojtur dhe janë publikuar dhe keqpërdorur, ky është një element që duhet të jetë në vëmendje në rastin e ngritjes së regjistrit kombëtar online për vullnetarizmin
- Regjistri online kombëtar mund të mos jetë i nevojshëm, nëse të gjitha organizata kanë **dokumentet dhe procedurat e tyre të brendshme** sa i përket regjistrimit të vullnetarëve dhe mbajtjes së të dhënave siç mund të jenë: regjistrat e brendshëm të organizatave, proces-verbale, listat e pjesëmarrjes, certifikata, vërtetime pjesëmarrjeje apo letra reference, apo marrëveshjet dhe kontratat e lidhura mes organizatave dhe vullnetarëve. Të gjitha këto dokumente mund të shërbejnë si provë për shërbimin vullnetar dhe vullnetarët e përfshirë në organizatë.

*\*Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit  
"Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet  
Themelore: Fuqizimi i OSHG-ve për procesin  
e anëtarësimit në BE", me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil  
Society Facility 2021*

